



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sallahu" Sh.P.K. të datës 27.08.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës (Mbikalimi dhe Nënkalimi për vetura dhe automjete) në Veternik mbi rrugën "A" - Bashkëfinancim me MMPHI-në" me nr. të prokurimit 616-26-6502-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sallahu" Sh.P.K. të datës 27.08.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës (Mbikalimi dhe Nënkalimi për vetura dhe automjete) në Veternik mbi rrugën "A" - Bashkëfinancim me MMPHI-në" me nr. të prokurimit 616-26-6502-5-1-1.**
- II. LEJOHET autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.**
- III. NJOFTOHEN palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sallahu" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës (Mbikalimi dhe Nënkalimi për vetura dhe automjete) në Veternik mbi rrugën "A" - Bashkëfinancim me MMPHI-në" me nr. të prokurimit 616-26-6502-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritu) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“Pretendimi 1

Pretendimi 1 i referohet Aneks 8 – “Paisjet e obligueshme për realizimin e punimeve”, ku kemi hasur në paisje krejtësisht të pa nevojshme për realizimin e projektit, krahasur me paramasën dhe parallogarinë e projektit dhe specifikimet teknike.

Po ashtu në këtë listë kemi parë se nuk janë vendosur paisje që vertet janë të domosdoshme për realizimin e projektit (psh automikser betoni, pompa uji etj).

Kjo listë shihet qartë se është e kurdisur duke ju pershtatur një operatori të caktuar dhe duke diskriminuar operatorët e tjerë ekonomik.

Për këtë arsye, kërkojmë rishikimin dhe ndryshimin e Aneksit 8, në mënyrë që lista e pajisjeve të përcaktohet në përputhje me nevojat reale të projektit, kërkesat funksionale dhe standardet teknike, pa krijuar kufizime të panevojshme për konkurrencën, në pajtim me nenin 28 të LPP-së

Për shembull, në pikën 1 është kërkuar: **“Ekskavatorë me zinxhir me peshë min. 53 ton, me kapacitet mbi 2.0 m³ (2 copë)”**.

Kërkesa për këtë kapacitet është e pajustificuar dhe joproportionale në raport me natyrën e punimeve të parapara në këtë projekt.

Punimet e gërmimit të parapara në Paramasë janë të kufizuara në gërmime të kategorive III-IV dhe, bazuar në natyrën dhe kushtet e terrenit të projektit, nuk janë evidentuar gërmime masive në shkëmb të fortë, gërmime të karakterit të gurorëve apo minierave, ose

volume të tilla të materialit që kërkojnë gërmime masive me ekskavator të klasës mbi 50 ton.

Prandaj, vendosja si kërkesë minimale e dy (2) ekskavatorëve me peshë 53 ton dhe kapacitet mbi 2.0 m³ nuk përkon me nevojat reale teknike të projektit dhe paraqet një kërkesë të panevojshme dhe kufizuese ndaj konkurrencës.

Për këtë arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të ndryshohet dhe të përcaktohet në mënyrë proporcionale me nevojat reale të projektit, duke kërkuar përdorimin e Ekskavatorëve me

kapacitet 0.4-1m³ dhe Ekskavatorë me kapacitet 1-2m³ që janë të mjaftueshëm për realizimin e punimeve të parapara në këtë projekt.

Në pikën 3 është kërkuar: Riper për ekskavator 20-30ton 1 cope -

Riperi është një pajisje që montohet në krahun e ekskavatorit dhe përdoret për shkëputjen,

çarjen dhe thyerjen e materialeve të forta, sidomos në tokë shumë të ngjeshur, argjilë të fortë, material shkëmbor etj.

Nga shqyrtimi i Paramasës, Parallogarisë dhe përshkrimit të punimeve, dhe nga gjendja e

terenit, nuk rezulton ndonjë pozicion apo kërkesë teknike që parasheh çarje, shkëputje apo thyerje të shkëmbit me përdorim të riper-it, prandaj kërkesa për këtë pajisje si pajisje obligative rezulton se nuk është e lidhur drejtpërdrejt me ndonjë punim konkret të

kontratës dhe nuk është e justifikuar teknikisht.

Për këtë arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të largohet nga lista e pajisjeve obligative, pasi nuk rezulton të jetë e domosdoshme për realizimin e punimeve të parapara në këtë kontratë.

Në pikën 4 është kërkuar Eskavator me zingjir gome, krahe kthyes dhe GPS me peshë min 18 ton (1 copë)

Kërkesa për GPS në ekskavator është e pajustificuar dhe tërësisht e kurdisur, pasi theksojmë me bindje të plotë se nuk ka operator ekonomik në Kosovë që ka njohuri dhe kapacitet real për përdorimin e këtij sistemi në ekskavator.

Ku ju bëjmë ftesë edhe t'i testoni publikisht, në prezencën tonë, operatorët ekonomikë që pretendojnë se e posedojnë dhe e përdorin këtë sistem.

Kjo kërkesë krijon dyshimin e arsyeshëm se është vendosur vetëm për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, i cili e ka të evidentuar sistemin GPS në Dokumentin Unik Doganor, ndërsa operatorët e tjerë ekonomikë përjashtohen nga përmbushja e kësaj kërkesë vetëm mbi bazën e një shënimi formal në dokumentacion, pa u dëshmuar përdorimi apo funksionaliteti real i këtij sistemi.

Andaj, kërkojmë që kjo kërkesë të largohet nga lista e pajisjeve obligative dhe që Autoriteti Kontraktues të bazohet në nevojat reale teknike dhe standardet e aplikueshme të

projektit, e jo në kërkesa formale dhe të panevojshme që kufizojnë konkurrencën.

Në pikën 7 është kërkuar Kamion kiper 3 deri 5 ton pesha bartëse 1 cope

Kërkesa për kamion kiper me kapacitet të përcaktuar ngushtë në intervalin 3-5 ton është e

pajustificuar teknikisht dhe përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Ky specifikim përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë kamionë kiper me kapacitet

më të ulët se 3 ton, por të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e punimeve të parapara në kontratë.

Në dosjen e tenderit nuk është dhënë ndonjë arsyetim teknik se pse është i domosdoshëm pikërisht kapaciteti minimal prej 3 ton, ndërsa përcaktimi i një intervali të tillë të ngushtë nuk rezulton nga ndonjë kërkesë konkrete e Paramasës dhe Paralogarisë.

Andaj, kërkojmë që kërkesa të ndryshohet nga "3-5 ton" në "deri në 5 ton", duke lejuar pajisjet e përshtatshme dhe duke shmangur kufizimin e panevojshëm të konkurrencës, në

përputhje me nenin 28, paragrafi 2 të LPP-së.

Në pikën 9 është kërkuar: "Ngarkues min. 30 ton - 1 copë".

Kërkesa për ngarkues me peshë minimale prej 30 ton është e pajustificuar teknikisht dhe përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi një ngarkues i kësaj peshe paraqet kapacitet të lartë, i cili nuk rezulton i domosdoshëm për realizimin e punimeve të parapara në projekt.

Në dosjen e tenderit nuk është dhënë ndonjë arsyetim teknik se pse është i domosdoshëm pikërisht një ngarkues me peshë minimum 30 ton, ndërsa përcaktimi i këtij pragu përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë ngarkues me kapacitet më të ulët, por të

përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e punimeve.

Andaj, kërkojmë që kërkesa të ndryshohet nga "Ngarkues min. 30 ton" në **"Ngarkues deri në 30 ton"**, duke mundësuar përdorimin e pajisjeve të përshtatshme për nevojat reale të projektit dhe duke shmangur kufizimin e panevojshëm të konkurrencës.

Në pikën 11 është kërkuar: "Buldozer me thikë lëvizëse dhe kthyesë në dy krahët, me GPS dhe kamera, me peshë min. 29 ton - 1 copë".

Kërkesa për buldozer me peshë minimale prej 29 ton është e pajustificuar teknikisht dhe përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi një kapacitet i tillë nuk rezulton i domosdoshëm për realizimin e punimeve të parapara në Paramasë dhe Parallogari.

Andaj, kërkojmë që kërkesa të ndryshohet nga "peshë min. 29 ton" në **"peshë deri në 29 ton"**, duke lejuar përdorimin e pajisjeve të përshtatshme për nevojat reale të projektit.

Sa i përket kërkesës për GPS dhe kamera, vlejné të njëjtat kundërshtime të potencuara më lart. Këto pajisje nuk janë të arsyetuara me ndonjë nevojë konkrete të projektit dhe nuk është përcaktuar funksioni i tyre teknik në realizimin e punimeve. Nuk mund të mjaftohet AK vetëm me faktin se këto pajisje janë të shënuara në dokumentacionin e ndonjë makinerie apo në Dokumentin Unik Doganor, pa u dëshmuar përdorimi dhe funksionaliteti i tyre real.

Theksojmë se këto kërkesa duken të vendosura vetëm mbi bazën e asaj që është evidentuar në dokumente, ndërsa nuk rezulton se operatorët ekonomikë kanë kapacitet real për përdorimin e sistemeve GPS dhe kamerave si pjesë funksionale të makinerive. Për këtë arsye, kërkojmë që këto kërkesa të largohen, pasi nuk lidhen me nevojat reale teknike të projektit dhe krijojnë kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Ne piken 12 eshte kerkuar Buldozer me thike levizese dhe kthyesë ne dy krahë me GPS dhe kamera me peshe min.20 ton. - edhe per kete pike, kërkojmë që të largohen kërkesat për GPS dhe kamera, pasi këto pajisje nuk lidhen me ndonjë nevojë të domosdoshme teknike të projektit dhe nuk janë të justifikuara në raport me objektin dhe natyrën e punimeve.

Në pikën 16 është kërkuar: "Cilindër Asfalti Gome-Hekur me peshë min. 9 ton - 1 copë".

Kërkesa për cilindër asfalti Gome-Hekur me peshë minimale prej 9 ton është e pajustificuar dhe joproporcionale me nevojat reale të projektit.

Përcaktimi i një peshe minimale kaq të lartë kufizon konkurrencën dhe kërkon pajisje me kapacitet më të madh se sa është e nevojshme për realizimin e shtresave asfaltike të parapara në projekt.

Duke marrë parasysh shtresat e parapara të asfaltit prej 10 cm, 7 cm dhe 4 cm, nuk rezulton ndonjë nevojë teknike që domosdoshmërisht kërkon cilindër me peshë minimum

9 ton.

Andaj, kërkojmë që kërkesa të ndryshohet nga "Cilindër Asfalti Gome-Hekur me peshë min. 9 ton" në **"Cilindër Asfalti Gome-Hekur me peshë deri në 9 ton"**, duke mundësuar përdorimin e pajisjeve të përshtatshme për realizimin e punimeve dhe duke shmangur kufizimin e panevojshëm të konkurrencës.

Ne piken 18 eshte kerkuar Ngjeshese hidraulike qe montohet ne bager me peshe 400kg deri 500kg.

Kërkesa për peshë të përcaktuar ngushtë, në intervalin 400–500 kg është e pajustificuar teknikisht dhe përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Përcaktimi i një intervali kaq të ngushtë përjashton pajisje të tjera me peshë të përafërt, të cilat kanë funksion dhe performancë të njëjtë ose të mjaftueshme për realizimin e punimeve të parapara.

Nuk rezulton ndonjë nevojë teknike në Paramasë apo Parallogari që kërkon pikërisht peshën 400–500 kg, andaj ky kufizim është i panevojshëm dhe nuk lidhet me funksionin real të pajisjes.

Andaj, kërkojmë që kërkesa të ndryshohet nga “400–500 kg” në “deri në 500 kg”, duke lejuar përdorimin e pajisjeve të përshtatshme dhe ekuivalente dhe duke shmangur kufizimet e panevojshme të konkurrencës.

Në pikën 19 është kërkuar: “Finisher për shtrirjen e asfaltit me gjerësi të shtrimit deri në 7.5 m – 1 copë”.

Nga specifikimet teknike të projektit nuk rezulton ndonjë kërkesë që shtrirja e asfaltit duhet të realizohet me finisher me gjerësi deri në 7.5 m.

Përkundrazi, projekti përcakton gjerësitë konkrete të korsive prej 3.3 m dhe 3.5 m, ndërsa rampat kanë gjerësi konstruksioni 5.00 m. Prandaj, përcaktimi i kapacitetit të finisherit deri në 7.5 m nuk rezulton të jetë i arsyetuar nga nevoja konkrete e projektit.

Nëse AK synon të sigurojë cilësinë dhe saktësinë e shtrirjes së shtresave asfaltike, kërkesa duhet të fokusohet në kapacitetin funksional të finisherit dhe sistemin automatik të nivelimit, i cili është drejtpërdrejt relevant për kontrollin e nivelit, trashësisë dhe pjerrësisë së shtresave, e jo në një kufizim të caktuar të gjerësisë së pajisjes.

Andaj, kërkojmë që pjesa rreth gjerësisë së shtrimit të largohet, duke zëvendësuar me nivelim automatik dhe duke lejuar pajisje ekuivalente që përmbushin kërkesat teknike të projektit.

Në pikën 20 është kërkuar: “Frez hidraulik për gërryerjen e gurit që montohet në bager, me peshë 1500–2000 kg – 1 copë”.

Kjo kërkesë është e pajustificuar dhe nuk përputhet me nevojat reale të projektit.

Siç rezulton nga projekti dhe specifikimet teknike, punimet e gërmimit të parapara kanë të

bëjnë me humus dhe gërmime të dheut të kategorisë III-IV, ndërsa nuk është parapare ndonjë pozicion për gërryerje apo prerje të masivit shkëmbor që do të kërkonte përdorimin

e frezit hidraulik për gur.

Për këtë arsye, kërkesa për këtë pajisje nuk lidhet me ndonjë punim konkret të parapare në

kontratë dhe nuk është e domosdoshme për realizimin e punimeve, andaj kërkojmë që kjo pajisje të largohet tërësisht nga lista e pajisjeve.

Ne piken 21 është kërkuar Makineri për nivelizimin e betonit me teknologji laserike

Kërkesa për “Makineri për nivelizimin e betonit me teknologji laserike” nuk është e përcaktuar në bazë të një rezultati teknik që duhet të arrihet, por në bazë të një teknologjie specifike.

Në dokumentacionin teknik të projektit nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë për toleranca të tilla të nivelimit/ rrafshësisë së betonit, e cila do ta bënte të domosdoshëm përdorimin e teknologjisë laserike.

Përderisa funksioni i nivelizimit të betonit mund të realizohet edhe me pajisje dhe metoda të tjera të përshtatshme, kërkesa për teknologji specifike laserike, pa arsyetim teknik konkret, përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës, dhe është vendosur në mënyrë favorizuese ndaj ndonjë operatori ekonomik të caktuar që e posedon këtë paisje.

Në pikën 27 është kërkuar: "Makineri shpimi gjeotermale për shpime horizontale me sistem laserik të kontrollit, 15-18 ton - 1 copë".

Kjo kërkesë nuk ndërlidhet me asnjë punim të paraparë në këtë projekt.

Nga shqyrtimi i Paramasës, Parallogarisë dhe specifikimeve teknike rezulton se projekti nuk parasheh asnjë pozicion për shpime horizontale, shpime gjeotermale apo instalime nëntokësore me metodë të shpimit horizontal.

Andaj, kërkesa për këtë makineri nuk ka lidhje me ndonjë pozicion konkret të kontratës dhe nuk është e domosdoshme për realizimin e punimeve të parapara. Kërkojmë që kjo pajisje të largohet tërësisht nga lista e pajisjeve, pasi vendosja e saj përbën kërkesë të panevojshme dhe kufizon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Ne piken 30 është kërkuar: "Mikser betoni për ekskavator - 1 copë".

Mikseri i betonit që montohet në ekskavator është pajisje e përshtatshme për përgatitjen dhe shpërndarjen e sasive të vogla të betonit për oborre/ shtëpia, ndërsa projekti në fjalë është projekt i madh infrastrukturor, që përfshin punime të konsiderueshme të betonit dhe

elementeve konstruktive, andaj përcaktimi i një kërkesë të tillë është qesharake.

Për realizimin e punimeve të tilla, metoda adekuate është përdorimi i automikserëve të betonit, për furnizimin, transportin dhe vendosjen e betonit, të përshtatshme për sasi të

kërkesat teknike të projektit.

Andaj, kërkojmë që kërkesa për "Mikser betoni për ekskavator" të largohet nga lista e pajisjeve dhe të zëvendësohet me kërkesë për Automikser betoni, në numër dhe kapacitet të përshtatshëm me sasi të reale të betonit të parapara në Paramasë dhe projekt.

Ne piken 32 është kërkuar Prerese asfalti për ekskavator deri 200kg

Kërkesa që prerësja e asfaltit të jetë domosdoshmërisht pajisje që montohet në ekskavator është e pajustifikuar dhe kufizuese, pasi prerja e asfaltit mund të realizohet në mënyrë të njëjtë dhe efektive edhe me prerëse të pavarur të asfaltit, të përshtatshme për punimet e parapara në projekt.

Andaj, kërkojmë që kjo kërkesë të ndryshohet duke lejuar përdorimin e prerëses së asfaltit

të përshtatshme për realizimin e punimeve, pa kushtëzuar që ajo të montohet në ekskavator.

Ne piken 33 është kërkuar Kompresor 7 bar

Kapaciteti i vendosur fiks 7 bar është diskriminues/favorizues dhe kufizon konkurrencën,

andaj kerkojmë që të zëvendësohet me “Kompresor ajri ”

Në pikën 34 është kërkuar Çekiç hidraulik me pesh max 950kg

Kërkesa për përcaktimin e peshës së çekiçit me maksimum 950 kg është kufizuese dhe joproporcionale, pasi përjashton pajisjet të cilat i pergjegjen nevojave të projektit , pasi një kapacitet i tillë është i pa mjaftueshem për këtë projekt.

Duke pasur parasysh natyrën dhe vëllimin e punimeve të projektit, kërkojmë që kërkesa të

ndryshohet nga “çekiç hidraulik me peshë max. 950 kg” në “çekiç hidraulik me peshë min. 950 kg.

35 Paisje për testim të kanalizimit prej R200 – R1200

Kjo kërkesë është e pajustificuar dhe kufizuese, pasi në dokumentacionin teknik nuk përcaktohet përdorimi i një pajisjeje të tillë specifike, as nuk arsyetohet teknikisht intervali

R200-R1200.

Kërkesa duket se është vendosur për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar që posedojnë këtë pajisje, dhe jo mbi bazën e një nevojë konkrete të projektit.

Andaj, kërkojmë që kjo pajisje të largohet nga lista e pajisjeve obligative, ose të përcaktohet vetëm funksioni/testi që duhet të realizohet, duke lejuar pajisje dhe metoda ekuivalente.

Pretendimi 2

Në lidhje me kërkesat për stafin profesional, konsiderojmë se përcaktimi i përvojës minimale prej 10 viteve pas diplomimit për pozitën e Menaxherit të Kontratës, Udhëheqësit të Punishtes, Inxhinierit të Makinerisë dhe Inxhinierit të Elektroteknikës – Energjetikës është i tepruar, joproporcional dhe kufizues për konkurrencën.

Nuk është e qartë se mbi çfarë nevojë konkrete teknike të projektit është përcaktuar pikërisht periudha 10-vjeçare, ndërsa një përvojë prej 3-5 viteve pas diplomimit, varësisht

nga pozita dhe përgjegjësitë, do të ishte kërkesë e arsyeshme dhe e mjaftueshme për të dëshmuar kapacitetin profesional, sepse një përvojë prej 3-5 viteve kërket në mënyrë

standardizuar edhe në projekte shumë më të mëdha infrastrukturore, përfshirë projekte me

vlerë mbi 35 milionë euro(psh nga MMPHI).

Një kërkesë e tillë favorizon operatorët ekonomikë që kanë staf me përvojë shumëvjeçare në përbërjen e tyre, ndërsa përjashton operatorë të tjerë ekonomikë që mund të disponojnë

inxhinierë të kualifikuar, të licencuar dhe profesionalisht të aftë, por të cilët nuk i kanë plotësuar hipotetikisht “10 vitet e kërkuara.

Për këtë arsye, kërkojmë që kërkesa për 10 vite përvojë pune të rishikohet dhe të përcaktohet në mënyrë proporcionale me kompleksitetin dhe nevojat reale të projektit, duke propozuar që përvojat minimale të përcaktohen në 3-5 vite pas diplomimit, sipas pozitës dhe përgjegjësisë konkrete.

Pretendimi 3

Në pikën 2.8 është kërkuar një ekip prej 20 punëtorësh, prej të cilëve së paku

2 manovratorë të certifikuar,

2 saldues të certifikuar për gypa HDPE sipas EN 13067:2013 dhe

2 instalues të ujit dhe kanalizimit, ku njëri prej tyre duhet të jetë i certifikuar edhe për testimin e gypave.

Këto kërkesa rezultojnë të panevojshme dhe jo proporcionale me nevojat konkrete të projektit, veçanërisht kërkesa për nga dy persona për secilin profil, pa u paraqitur ndonjë arsyetim teknik se pse është i domosdoshëm ky numër.

Për më tepër, në projekt janë paraparë punime me një numër të madh të pajisjeve, ndërsa kërkimi i vetëm dy manovratorëve të certifikuar nuk paraqet ndonjë lidhje të qartë me organizimin real të punimeve.

Nëse AK konsideron se certifikimi i manovratorëve është i domosdoshëm, atëherë kërkesa

duhet të arsyetohet në bazë të numrit dhe natyrës së pajisjeve që realisht do të operohen, dhe jo të përcaktohet arbitrarisht vetëm numri "2", prandaj konsiderojmë se duhet të largohet krejtësisht si kerkese, sepse është përcaktuar vetëm për të favorizuar një operatore ekonomik, që në ekipin e tij ka 2 persona të me certifikime të tilla, dhe për të përjashtuar operatorët e tjerë.

Po ashtu, edhe sa i përket salduesve dhe instaluesve të "certifikuar" nuk jepet as edhe një sqarim se ku lëshohen këto certifikata, nga çfarë institucioni, dhe çfarë roli kanë në këtë projekt.

Andaj, kërkojmë që këto kërkesa të kurrdisen të largohen nga Dosja e Tenderit, pasi që krijojnë kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe favorizojnë operatorë ekonomikë që

paraprakisht posedojnë këtë strukturë specifike të stafit.

Pretendimi 4

Në shqyrtimin e Dosjes së Tenderit kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një numër të madh të kërkesave për pajisje, makineri dhe kapacitete të ndryshme, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat reale të projektit dhe nuk rezultojnë të domosdoshme për realizimin e punimeve të parapara në Paramasë dhe Paralogari.

Në të njëjtën kohë, është e paarsyeshme që në një projekt të kësaj natyre dhe përmasash të mos jenë përcaktuar kërkesa konkrete që lidhen me sigurimin e materialeve kryesore të nevojshme për realizimin e punimeve, veçanërisht për asfaltin, betonin dhe materialet minerale/agregatet.

Projekti përfshin punime të konsiderueshme të asfaltimit, betonimit, ndërtimit të strukturave dhe përdorimit të materialeve minerale, andaj siguri i këtyre materialeve nga burime të licencuara dhe të kontrolluara paraqet një element thelbësor për realizimin cilësor dhe të sigurt të kontratës.

Për këtë arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues duhet të përfshijë në Dosjen e Tenderit kërkesa që dëshmojnë se operatori ekonomik ka kapacitet të sigurt dhe të ligjshëm për sigurimin e këtyre materialeve, qoftë përmes kapaciteteve të veta, qoftë përmes marrëveshjeve me operatorë ekonomikë të licencuar.

Konkretisht, kërkojmë që në Dosjen e Tenderit të përfshihet kërkesa si në vijim:

"OE duhet të jetë i licencuar dhe të ketë leje për aktivitete të veçanta për prodhimin e bazës së asfaltit, prodhimin e bazës së betonit dhe duhet të jetë i licencuar si

gurëthyes/zhavorr.

Dëshmia : Kopja e licencës/lejes për aktivitete të veçanta të vlefshme, e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale.

Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon licencën përkatëse, duhet të ofrojë marrëveshje për furnizim me OE të licencuar. Bashkëngjitur marrëveshjes duhet të jenë licencat e OE-së furnizues. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti, me validitet për kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët."

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me nevojat reale të projektit dhe me materialet kryesore që do të përdoren gjatë realizimit të punimeve".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kërkesat për stafin profesional dhe për pajisjet/makinerinë dhe kërkesat tjera në DT janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Në anën tjetër pretendimet e parashtruesit për të shtuar kërkesa të reja janë absolutisht në kundërshtim me LPP konkretisht me nenet 1, 6, 7, 28 dhe 29 të LPP. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.